

PERGJIGJJA E ARDHUR NGA AGJENCIA PER MEDIA DHE INFORMIM:

Lidhur me kërkesën tuaj për informacion të datës 08.05.2023, lutem gjeni si në vijim sqarimet për secilën prej kërkesave;

Ju bëjmë me dije se në funksion të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor për Zgjedhjet Vendore të 14 Maj 2023, më datë 20.4.2023 Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 234, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023”.

Në funksion të zbatimit të kësaj VKM-je dhe në koordinim të procesit të monitorimit, është parashikuar ngritja e një grupi Task Force, si një grup pune *ad hoc*, me përfaqësim të lartë ndërinstitucional.

Task Forca ka zhvilluar **3 takime**, përkatësisht në datat 27.04.2023/ 04.05.2023/ 12.05.2023. Takimet e sipërcituara kanë pasur rend dite si më poshtë vijon:

1. Përcaktimin e Detyrave për anëtarët e Task Forcës;
2. Raportime të problematikave nga anëtarët e Task Forcës;
3. Miratim i Planit të Veprimit;
4. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit nga anëtarët e Task Forcës;
5. Raportim nga DAP mbi zbatimin e Vendimit nr. 234, datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave dhe Planit të Masave miratuar nga Task Forca;
6. Detyrat për Sekretariatit Teknik;

Ndër detyrat që Task Forca ka kryer ka qenë fillimi i punës për krijimin e kushteve të nevojshme nëpunësve civilë dhe garantimin e mos cënimit të të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjisllacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor si dhe garantimi i pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administratës zgjedhore, si KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të jetë njoftuar paraprakisht me shkrim eprori direkt dhe njësia e personelit për këtë veprimtari.

Task Forca ka kërkuar raportimin nga DAP lidhur me rastet e pezullimit të kandidatëve të regjistruar në zgjedhjet vendore të vitit 2023, ngritja e Grupit të Punës mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore 2023, si dhe hartimin e rregullores së brendshme të institucionit, mbi përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil, gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet lokale 2023.

Në ushtrim të detyrave të veta Task Forca ka bërë monitorimin e sjelljes dhe veprimtarisë së nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore si dhe ka kërkuar nga DAP caktimin e

përfaqësuesve përgjegjës për secilin sistem ministror si dhe monitorimin dhe pezullimin e procedurave administrative të rekrutimit në administratën publike.

Në mbledhjen e fundit të zhvilluar nga Task Forca, atë të datës 12.05.2023, pas raportimeve nga anëtarët mbi situatën më të fundit nga monitorimet dhe veprimtaritë e tyre u vendos që pas zgjedhjeve, hartimi i raportit përfundimtar të Task Forcës i cili përmbyll dhe veprimtarinë e këtij komisioni *ad hoc* të ngritur nga Qeveria Shqiptare me qëllimin marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023.